

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
UJËSJELLËS SH.A. URA VAJGURORE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Ujësjiellës sh.a. Ura Vajgurore, Berat**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 94, datë 31.7.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 388/6, datë 31.7.2014, i ka rekomanduar z. Petref Sula, Administrator i Ndërmarrjes të Ujësjiellës sh.a. Ura Vajgurore, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore në çdo fund viti të hartoj dhe miratoj, programin vjetor të zhvillimit ekonomik të shoqërisë dhe programet mujore, bazuar në objektivat kryesore të zhvillimit të shoqërisë dhe t’ia paraqesë për miratim këshillit mbikëqyrës

Brenda muajit Dhjetor 2014 dhe vazhdimësi

2. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore të marrë masa për të vënë në funksionim sistemet e IT-së, për përmirësimin e aktiviteteve menaxhuese dhe të kontrollit në arritjen e objektivave të saj.

Menjëherë

3. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore të marrë masa për përmirësimin e performancës për treguesit prodhim-faturim, faturim-arkëtim dhe ulja e humbjeve në rrjet, me qëllim përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë, si dhe të gjenden burime financimi për likuidimin e 15,349,456 lekë ndaj 43 furnitorëve të vitit 2013.

Vazhdimisht

4. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore të marrë masa duke kryer rakordim e shumave financiare dhe të kërkoj në rrugë administrative e ligjore likuidimin e debitorëve të Bashkisë Ura Vajgurore në vlerën 738,045 lekë dhe të Komunës Otlak në vlerën 1,705,454 lekë.

Brenda muajit Tetor 2014

5. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore të marrë masa për identifikimin e abonentëve familjarë, subjekteve private dhe institucione buxhetore, duke përcaktuar zonën sipas vendndodhjes së tyre dhe të ndiqen hapat ligjore për të lidhur kontratat e furnizimit me ujë.

Brenda muajit Tetor 2014

6. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore të marrë masa duke ngritur grup pune të përbashkët me Bashkinë Ura Vajgurore dhe Komunën Poshnje, dhe të ndjek hapat ligjorë për evidentimin e të gjithë abonentëve që furnizohen me ujë por faturohen në mënyrë afrofe, duke i pajisur me matës të konsumit të ujit, si dhe për vjeljen e arkëtimin e detyrimit në vlerën 1,765,2361 lekë ndaj 436 abonentëve që furnizohen me ujë të pijshëm.

Brenda muajit Tetor 2014

7. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore të marrë masa duke ngritur grup pune të përbashkët me Bashkinë Ura Vajgurore dhe Komunën Poshnje, për azhurnimin e të dhënave për numrin e familjeve dhe bizneseve që kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri, me numrin e familjeve në Zyrat e Gjendjes Civile në Bashki e Komunë, numrin e familjeve që kanë lidhur kontratë me OSSHE në Ura Vajgurore, si dhe

numrin e subjekteve private në Drejtorinë e Tatim Taksave Berat dhe Sektorin e Taksave e Tarifave të Bashkisë Ura Vajgurore.

Brenda muajit Tetor 2014

8. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore të marrë masa për hartimin e rregullores së funksionimit të brendshëm duke integruar në përmbajtje të saj të gjitha kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”.

Brenda muajit Tetor 2014

9. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore të marrë masa duke ngritur grup pune të përbashkët me Bashkinë e Komunën për rastet e lidhjeve të paligjshme për ujin e pijshëm, të evidentuara në magjistralin kryesor, në zonën e fshatit dhe zonën informale të qytetit, duke zbatuar të gjitha funksionet ligjore në fuqi.

Brenda muajit Tetor 2014

10. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore, Administratori i Shoqërisë, të marrë masa për vendosjen e referencave ligjore, në nxjerrjen e urdhëresave dhe vendimeve si dhe të protokollohet në librin e protokollit të shoqërisë.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

11. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore të marrë masa lidhur me ushtrimin e kompetencave të veta në përputhje me detyrat që rrjedhin nga statuti i shoqërisë dhe vendimeve të këshillit mbikëqyrës;

-të informojë këshillin mbikëqyrës mbi rezultatet e auditimit të kryer nga KLSH, duke programuar masat për përmirësimin e gjendjes,

-të informojë këshillin mbikëqyrës mbi detyrat e lëna për zbatim,

-të lidh kontratë të rinovueshme vjetore me këshillin drejtues,

-të paraqesë këshillit mbikëqyrës, llogaritë vjetore brenda tre muajve nga mbyllja e ushtrimit financiar, me qëllim verifikimi dhe kontrolli dhe

-të informojë mbi aktivitetin e shoqërisë dhe për më tepër për rezultatet e treguesve kryesorë ekonomik të shoqërisë, Bashkinë dhe Komunën, si aksionarë të vetëm të shoqërisë.

Vazhdimisht

12. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore të marrë masa duke ngritur grup pune me specialistë të fushave përkatëse për të kryer inventarizimin e aseteve të shoqërisë, dhe vlerësimin e tyre, duke synuar:

- të përfshijë në asetet e saj duke i pasqyruar në bilancet vjetore; investimin e kryer,

- të përfshijë në asetet e saj duke evidentuar në kontabilitet, vlerat materiale të përfituara dhe të magazinuara,

-të hap kartelat e materialeve me çelje sipas të dhënave të inventarit,

-të hapë ditarët për magazinën dhe të regjistrohen veprimet e hyrje dhe daljeve,

-të sistemohen materialet në magazinë duke vendosur etiketat e materialeve me çmimet përkatëse dhe

-të nxirret përgjegjësia për diferencat eventuale nga rezultatet e inventarizimit

Brenda muajit Tetor 2014

13. Drejtoria e Ujësjiellës Ura Vajgurore të marrë masa për të rishikuar strukturën organizative dhe sistemin e pagave, miratimin në këshillin mbikëqyrës me synim:

-të ndërtohet sistemi i pagave duke respektuar nivelin e pagave minimale sipas miratimit me VKM dhe

-të zvogëlohet fondi i pagave në përputhje me mundësitë financiare të shoqërisë.

Brenda muajit Tetor 2014

14. Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të marrë masa duke analizuar Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të dalë me vendime konkrete në zbatim të rekomandimeve, duke hartuar program masash me afate konkrete, me qëllim përmirësimin e gjendjes ekonomiko financiare të shoqërisë.

Brenda muajit Tetor 2014

15. Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të marrë masa për të raportuar pranë Ministrin të linjës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për veprimtarinë ekonomiko financiare të shoqërisë.

Vazhdimisht

16. Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të marrë masa për të hartuar një program vjetor për zhvillimin e veprimtarisë së tij dhe në përmbushje të kërkesave të Drejtorisë dhe Asamblesë së Aksionarëve.

Brenda muajit Tetor 2014

17. Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të marrë masa për mbajtjen e një regjistri të pjesëmarrjes në mbledhjet e tij, i cili duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje, pavarësisht formës së vendimmarrjes.

Vazhdimisht

18. Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të marrë masa për të zhvilluar veprimtarinë e tij mbikëqyrëse e vendimmarrëse duke përmbushur detyrimin ligjor për tu mbledhur të paktën një herë në tre muaj.

Vazhdimisht

19. Të merren masa, nga Këshilli Mbikëqyrës, për të programuar e ushtruar kontroll ndaj Drejtorisë e cila administron shoqërinë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 154.

Vazhdimisht

20. Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të marrë masa për të kryer një analizë në Degën e Shitjes për treguesit e faturimit, arkëtimit, vendosjen e matësve dhe lidhjen e kontratave të reja, me qëllim përmirësimin e këtyre treguesve dhe realizimin e objektivave të shoqërisë.

Brenda muajit Tetor 2014

21. Asambleja e Aksionarëve, të marrë masa që të programohen e të zhvillohen mbledhje të asamblesë të ortakëve, sipas përcaktimeve të nenit 136 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarë e shoqëritë tregtare”.

Vazhdimisht

22. Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë ndaj ish-administratorit dhe komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të makinerive e pajisjeve në vlerën 2,669,451 lekë.

Menjëherë

23. Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë ndaj ish-administratorit dhe komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të makinerive e pajisje të shoqërisë në vlerën prej 2,669,451 lekë.

Menjëherë

24. Administratori i Shoqërisë, në bashkëpunim me Bashkinë Ura Vajgurore dhe Komunën Poshnje, ti kërkoj zyrtarisht operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike OSSHE sh.a., për tarimin e kolaudimit e matësve të konsumit të energjisë elektrike.

Brenda muajit Tetor 2014

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Shoqëria e Ujësjiellës sh.a. Ura Vajgurore të marrë masa duke kryer kontabilizimin dhe të kërkoj në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si dhe procedurat përmbartimore për shpërbllimin e dëmit me **vlerën 1,457,616 lekë**, duke nxjerrë akt administrativ, *si më poshtë*:

B.1 Për vlerën 261,000 lekë ndaj 6 personave për përfitim të padrejtë në dieta.

Brenda muajit Nëntor 2014

B.2 Për vlerën 96,600 lekë ndaj subjektit “M...” sh.p.k. si pasojë e përfitimeve të padrejta për punime të pakryera.

Brenda muajit Shtator 2014

B.3 Për vlerën 83,836 lekë ndaj 34 punonjësve të Sh.a. Ujësjetllës për përfitim të padrejtë nga fondi i veçantë.

Brenda muajit Nëntor 2014

B.4 Për vlerën 672,000 ndaj subjektit R.H. përsa përfituar më tepër në dhënien e objektit me qira sh.a. Ujësjetllësit për periudhën e vitit 2007 deri 2013.

Brenda muajit Nëntor 2014

B.5 Për vlerën 198,012 lekë ndaj subjektit “R...” sh.p.k. për mosshlyerje të detyrimit për blerje të materialit “Skrapi” (*vlera 159,012 lekë për moslikuidim të blerjes së skrapit në afat sipas kontratës dhe vlera 39,000 lekë për kamatëvonesat*).

Brenda muajit Nëntor 2014

B.6 Për vlerën 24,000 lekë ndaj J.M. me detyrë ish juriste përsa përfituar më tepër për mos llogaritje të tatimit në burim.

Brenda muajit Shtator 2014

B.7 Të dalë akti administrativ në vlerën 10,000 lekë për përfitim të padrejtë, në investimin “Shtesë në linjën e furnizimit me ujë” Ura-Vajgurore”, pasi nga kthesa e Çiflikut deri te kryqëzimi i lagjes gurore, është paguar subjekti për punime të pakryera.

Brenda muajit Shtator 2014

B.8 Të dalë akti administrativ në vlerën 112,168 lekë për përfitim të padrejtë, pasi në investimin për punimet e kryera në rrjetin e brendshëm të furnizimit me ujë në lagjen “18 Tetori” rezulton se janë vendosur 5 puseta nga 7 dhe aksesoret janë vendosur vetëm për dy puseta, duke u paguar subjekti për punime/mallra të pakryera/vendosura.

Brenda muajit Nëntor 2014

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 154 dhe 158, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratave individuale të punës, kërkojmë nga Administratori i SH.A. “Ujësjetllësi” Ura Vajgurore, që bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Udhëzimit nr. 318, datë 08.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e shoqërive anonime shtetërore” të METE, pika IV/2, si dhe Statusit të Shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “**Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna**”, për punonjësit:

1. N.P. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës

Për shpenzime të kryera për udhëtim e dieta pasi është paguar padrejtësisht vlera prej 261.000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” .

Për shpenzimet e kryera për blerje me vlera të vogla nga ku rezulton se është paguar shuma prej 96,600 lekë por e pa justifikuar me dokument provues.

Për kryerjen e procedurave të prokurimit me vlera të vogla në mungesë të 3 ofertave dhe gjurmë të testimit të tregut, pra dokumentacion që të faktojë së komisioni ka testuar tregun, duke kryer veprime vetëm me një subjekt, në kundërshtim me pikat 1, 2, 4 dhe pika 5 UKM nr. 2 datë 18.02.2008. “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, si dhe nenet 8 dhe 11, Kreu I- rë të ligjit nr. 8402, datë

10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe me pikën 8.3 të UKM, nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Për përdorimin e fondit të veçantë për 34 punonjësit të cilët kanë përfituar më tepër vlerën 87,076 lekë, veprim që bie ndesh me VKM nr. 493, datë 06.07.2001 “Për Fondin e veçantë” e ndryshuar.

Për inventarizimin nxjerrje jashtë përdorimit të materialeve (*Tubo, transformator, pompa, saraçineska, kioskë, mjete transporti etj*) për sasinë 65 tonë me vlerë 2,388,024 lekë me tvsh dhe 1,990,020 lekë pa tvsh, pa sqaruar mbi shkaqet apo arsyet për nxjerrje jashtë përdorimi, pa llogaritur përqindjen e amortizimit, si dhe fitimin për ndërmarrjen nga shitja për SKRAP të këtyre pasurive, si dhe për nxjerrjen e vendimit pa numër e datë për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave pasurore (aktiveve), në kundërshtim me gjurmën “h” pika 103, 106 dhe 122.

gjurmën (*Tubo, transformator, pompa, saraçineska, kioskë, mjete transporti etj*).

Si anëtare e Komisionit të posaçëm të ngritur për zhvillimin e ankandit nuk ka marrë informacion për çmimin e shitjes nga INSTAT ose çmime ndërkombëtare, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin Publik” i ndryshuar me ligjin nr. 10346, datë 04.11.2010.

Si anëtare e Komisionit të posaçëm nuk ka bërë specifikime për llojin e materialeve që do shitet, duke shitur dhe materiale jo çelik, si transformatorë, pompa uji, tricikël, kioskë etj (materiale në inventar me vlerën 2,669,451 lekë) në kundërshtim me ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 dhe VKM nr. 692, datë 18.10.2011.

Në tenderin e dytë të zhvilluar është bërë dorëzimi i mallit pa u likuiduar vlera 159,012 lekë si dhe pa u llogaritur kamatëvonesa në vlerën 39,000 lekë (gjithsej 198,012 lekë) në kundërshtim me nenin 24 të kushteve të kontratës lidhur më datë 24.05.2013.

Nuk janë zbatuar kërkesat e nenit 4 të kontratës lidhur me afatin e kontratës 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës; nenit 18 ku përcaktohet se 50% e vlerës së kontratës do parapaguhet me nënshkrimin e kontratës; nenit 24 lidhur me likuidimin e dëmit për dorëzimin e vonuar, ku për kontrata për periudhë zbatimi deri 6 muaj, tarifa ditore do jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa zbatuar nga çmimi total i kontratës për 180 ditë dhe kamatëvonesa në vlerën 39,000 lekë; po ashtu nuk është likuiduar pjesa tjetër e kontratës deri në momentin e dorëzimit të sasisë totale të mallit në vlerën 159,012 lekë me tvsh.

Për punë të dobët lidhur me menaxhimin e debive e kredive sidomos për llogarinë 401 “Furnitorë” e cila në datë 31.12.2013 në kontabilitet paraqitet në vlerën 15,349.456 lekë e përbërë nga 43 subjekte, për zëra si karburanti në vlerën 523,960 lekë, blerje klori vlera 582,000 lekë, kancelari vlera 283,190 lekë, OSSHE në vlerën 11,817,763 lekë etj.

Për punë të dobët lidhur me eliminimin e debitorëve të cilët deri më 31.12.2013 paraqiten në vlerën 1,765,361 lekë që përbëhet nga 463 raste prej të cilëve abonent në qytet në 304 raste për vlerën 991,254 lekë, abonentë në fshat 152 raste për vlerën 603,700 lekë dhe abonentë privat në 7 raste për vlerën 170,407 lekë.

2. E.A. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës Teknike

Në dokumentacionin teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit në investimin nga kthesa e Çiflikut deri te kryqëzimi i lagjes “Gurore” për objektin “Shtesë në linjën e furnizimit me ujë” Ura-Vajgurore dhe për punimet e kryera në rrjetin e brendshëm të furnizimit me ujë në lagjen “28 Nëntori” Guri i Bardhë me vlerë 380.420 lekë pa t.v.sh, në lagjen “18 Tetori” Qendër me vlerë 87.737 lekë pa t.v.sh, si dhe në lagjen “Skrevan-Vokopol” me vlerë 248.595 lekë pa t.v.sh ose në total me vlerë 716.752 lekë pa t.v.sh.

Për mungesa dhe shkelje në dokumentacionin teknik, pasi nga 7(shtatë) puseta të planifikuara janë vendosur 5(pesë) puseta; nuk janë bërë lidhjet në rrjet dhe nuk janë funksionale; si dhe se aksesorët janë vendosur vetëm për dy puseta, duke u përfituar tepër 112,168 lekë (nga mos llogaritja e saktë e çmimit të

pusetës), në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Mungesa dhe shkelje në dokumentacionin teknik; pasi Mungon grafiku i punimeve; mungojnë certifikatat e cilësisë për materialet e përdorura në linjën shtesë të ujit; mungojnë procesverbalet për punimet e maskuara; mungon plan organizimi për punimet e ndërtimit; mungon projekt i plotë për ndërtimin e linjës shtesë të ujit; mungojnë aktkontrollat e kryera nga autoriteti kontraktor; si dhe mungojnë specifikimet teknike, të përgjithshme dhe të veçanta.

Si anëtare e Komisionit të posaçëm i ngritur për zhvillimin e ankandit të tubove të nxjerra nga nëntoka për SKRAP nuk ka proceduar për informimin e çmimeve ndërkombëtare të bursave apo nga INSTAT për çmimet e materialeve që shiten për SKRAP, veprim në kundërshtim me ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin Publik”, i ndryshuar.

Për lejimin e humbjeve në rrjet rreth 63% e prodhimit të ujit të pijshëm pa marrë apo propozuar asnjë masë për uljen e kësaj humbje

Shënim:

Për z. A.Ç. me detyrë ish-Administrator i Ndërmarrjes “Ujësjiellësi” sh.a. Ura Vajgurore, do të kishim propozuar masë disiplinore **“Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës të punës”**, por rekomandimi konsiderohet i ezauruar pasi rezulton të jetë larguar nga kjo detyrë më datë 03.03.2014.

Nga Ujësjiellës sh.a. Ura Vajgurore, Berat me shkresë nr. 83, datë 25.8.2014 e protokolluar në KLSH me nr. 388/6 datë 26.8.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Skënder Muca, Sotir Kosdine, Piro Imëaj, Jonild Hoxhaj dhe Ryisim Xhaja, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.